



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



PROCESVERBAL 2/2025

I Mbajtur në takimin e II-të të rregulltë të KPF-së me datën **26.02.2025**, në ora **10⁰⁰** në Zyrën e takimeve të Kryetari i Komunës, nën kryesimin e Kryesuesit të KPF-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. Xhavit Zariqi, Kryesues;
2. Arian Imeri, Anëtar
3. Lumnije Morina, Anëtare;
4. Mimoza Pajaziti, Anëtare;
5. Lulzim Abazi, Anëtar;
6. Brahim Osmani, Anëtar;
7. Shqipe Jashari, Anëtare;
8. Hatixhe Bungu Qerimi, Anëtare;
9. Flamur Istrefi, Anëtar.

Drejtorët e drejtorive;

1. Arbër Bytyqi – Drejtor i Urbanizmit dhe Mjedisit;
2. Afrim Llabjani – Drejtor i Arsimit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Përshëndetje të pranishëm, anëtarë të KPF-së, shoqëria civile, Drejtor të drejtorive, pra po fillojmë me mbledhjen e II-të të rregullt të KPF-së, besoi që materialin e keni marr me kohë dhe ju dëshiroi mirëseardhje në mbledhjen e KPF-së dhe propozojë këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KK-së;
4. Propozim - Vendim për Miratimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Ferizajt për Vitin 2025;
5. Propozim - Vendim për caktimin e dy anëtarëve nga Kuvendi i Komunës për Komision për ndarjen e bursave për studentë për Vitin shkollor 2024/2025 dhe
6. Të ndryshme.

Pika shtesë

1. Propozim – Vendim për ndryshimin e vendimit 01.Nr. 20 për plotësimin e listës rezervë me emërtimet e rrugëve dhe shesheve publike në Komunën e Ferizajt dhe
2. Propozim - Vendim për caktimin e anëtarëve nga Kuvendi i Komunës për Komision për ndarje të banesave.

Pika 1

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Fillojmë me pikën e I-rë të rendit të ditës, Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së, të gjithë jemi prezent.

Pika 2

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – A ka dikush të diskutoi rreth rendit të ditës?

Mimoza Pajaziti - Përshendetje të pranishëm, faleminderit kryesues, në kuadër të kësaj d.m.th. të këtyre pikave, unë kisha me propozu të futet në rend dite Propozim - Vendimi për komisionin e banesave që ka qenë në seancën e fundit dhe që në këtë seancë të formohet ky komision.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Dikush tjetër?

Arbër Bytyqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, media, shoqëri civile, unë propozoi që të futet si pikë e re e rendit të ditës edhe Propozim – Vendimi për ndryshimin e Vendimit 01.Nr. 20 për plotësimin e listës rezervë me emërtimet e rrugëve dhe shesheve publike në Komunën e Ferizajt, pasi disa emra rezervë janë kthyer, vendimi nga ministria që nuk ka qenë në përputhje me ligjin, bëhet fjalë për një 7 - 8 emra që janë kthyer nga lista që është bërë në seancën e fundit, kryesisht janë gabime teknike.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Pra kemi dy propozime për rend dite, njëra është për ndarje të banesave dhe Propozim – Vendimi për ndryshimin e Vendimit 01.Nr. 20 për plotësimin e listës rezervë me emërtimet e rrugëve dhe shesheve publike në Komunën e Ferizajt, dikush tjetër, a jeni për miratimin e këtij rendi të ditës me këto dy pika shtesë të propozuara për kuvend, kush është për?, faleminderit?, 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e III-të të rendit të ditës.

Pika 3

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Vazhdojmë me Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të KPF-së; a ka dikush ndonjë vërejtje rreth procesverbalit të mbledhjes së kaluar, si duket jo, a jeni që të kaloni procesverbalin e mbledhjes së kaluar?, faleminderit, 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e IV-të të rendit të ditës.

Pika 4

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për Miratimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Ferizajt për Vitin 2025, a ka dikush të diskutoi për këtë pikë, si duket jo, a jeni që të kaloni ky propozim për kuvend?, faleminderit, 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e V-të të rendit të ditës.

Pika 5

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për caktimin e dy anëtarëve nga Kuvendi i Komunës për Komision për ndarjen e bursave për studentë për Vitin shkollor 2024/2025, a ka dikush të diskutoi për këtë pikë të rendit të ditës, apo po e procesojmë për kuvend?, si duket jo, a jeni që të kaloni ky propozim për kuvend?, faleminderit, 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e VI-të të rendit të ditës.

Pika 6

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Vazhdojmë me Propozimin e Mimosës, Propozim - Vendim për caktimin e anëtarëve nga Kuvendi i Komunës për Komision për ndarje të banesave, pra duhet të shkoi edhe kjo në kuvend.

Mimoza Pajaziti – Është ligji për komision për caktimin e anëtarëve për çështje të banesave dhe gjithherë ka shkuar me anëtarët e pozitës dhe opozitës me ma shumë anëtarë dhe numri ka qenë 7 anëtarë ose 9 për komision, pra prej dy partive ma të mëdhaja politike kanë shku.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Analizoni simbas ligjit, sa anëtarë dhe në kuvend e propozoni, a jeni që të kaloi ky propozim për kuvend?, faleminderit, 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon dhe e kemi, Propozim – Vendimin për ndryshimin e Vendimit 01.Nr. 20 për plotësimin e listës rezervë me emërtimet e rrugëve dhe shesheve publike në Komunën e Ferizajt, të cilën e ka kthyer ministria për shkaqe teknike, a ka naj diskutim, kush është për?, faleminderit, 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e rendit të ditës në të dryshme, a ka dikush të diskutoi, nuk ka, atëherë po e shohë të mbyllur këtë mbledhje të KPF-së, faleminderit për pjesëmarrje.

Procesmbajtësja


Zyliha Tafarshiku

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Xhavit Zariqi

